



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 15, Datë 10.01.2018

MBI

**MIRATIMIN E KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME TË KONTRATËS SË SHËRBIMIT
UNIVERSAL TË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE PËR KLIENTËT
FUNDORË**

Në mbështetje të nenit 16, 20 gërmat “a” dhe “h”; nenit 80, 81, 82, 83, 84, 85, 94 dhe 96 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.01.2018, mbasi shqyrtoi relacionin mbi miratimin e “Kushteve të përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Fundorë”, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike,

Konstatoi se:

- Me Vendimin nr. 59, datë 29.04.2016 Bordi i ERE-s vendosi : “Fillimin e procedurave miratimin e “Kushteve të përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientet Fundorë”.
- Në shkresën nr.351 Prot, datë 04.05.2016, ERE u ka dërguar të gjitha palëve të treta dhe grupeve të interesit, Draft Kontratën mbi “Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Fundorë” për konsultim dhe për të marrë komente me qëllim përmirësimin e parashikimeve të propozuara nga grupi i punës.
- Në shkresën me nr. 351/8, datë 06.06.2017 dhe shkresën me nr. 195/3, datë 24.03.2017 Autoriteti i Konkurrencës ka dhënë komentet përkatëse.
- Në shkresën nr. 351/9 Prot, datë 04.07.2016 Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka shprehur dakortësinë e saj lidhur me Draft –Kontratën.
- Në shkresën në nr. 351/1, datë 17.05.2016 MZHETTS-i, ka paraqitur komentet e tij lidhur me Draft-Kontratën.
- Në shkresën me nr. 351/3Prot, datë 19.05.2016 subjekti “Bashkimi i Sindikatave të Pavarura” ka paraqitur sugjerimet e tij lidhur me Draft -Kontratën.
- Në shkresën nr.351/1 Prot, datë 25.05.2016 “Operator i Sistemit të Transmetimit”, ka paraqitur komentet e tij.
- Në shkresën me nr.351/2 Prot, datë 17.05.2016 “Shoqata e Konsumatorit Shqipëtare”, ka paraqitur komentet e saj lidhur me Draft -Kontratën.

- Në shkresën me nr. 429/1 Prot, datë 06.06.2016 “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, ka paraqitur 2 Draft-Kontrata:
 - “Kushtet e Përgjithshme të Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike, për Klientet Familjarë”
 - “Kushtet e Përgjithshme të Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët JoFamiljarë”
- Në shkresën me nr. 508 Prot, datë 04.07.2016, ERE, ka njoftuar të gjitha palët që kanë dërguar komente për zhvillimin e një seance dëgjimore.
- Në shkresën me nr. 195 Prot, datë 27.02.2017, ERE u ka dërguar të gjitha palëve të interesuar Draft -Kontraten dhe komentet e “OSHEE”sha, lidhur me këtë Draft -Kontratë të paraqitur pranë ERE-s, me shkresën nr. 5655 Prot, datë 13.02.2017.
- Në shkresën me nr. 195/3 Prot, datë 24.03.2017 “Autoriteti i Konkurrencës”, konfirmon se Draft-Kontrata mbi “Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjarë” nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”.
- Në shkresën me nr. 195/1 prot, datë 09.03.2017, subjekti “Bashkimi i Sindikatave të Pavarura” ka paraqitur të njëjtat sugjerime si në shkresën nr. 351/3Prot, datë 19.05.2016.
- Në shkresën me nr. 195/4 prot, datë 29.03.2017 “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes” ka shprehur komentet e saj lidhur me propozimet e “OSHEE”sh. a, mbi ristrukturimin e Draft –Kontratës.
- ERE ka analizuar të gjitha komentet e dërguara nga palët dhe ka reflektuar në Draft – Kontratë ato komente që i ka gjykuar të arsyeshme, në diskutim me palët, e që nuk bien ndesh me legjislacionin në fuqi.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë “Kushtet e përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Fundorë”,.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, do të njoftojë palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI